



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
MINISTRI

Nr. 3358/ prot.  
11

Tiranë, më 21 . 8 .2024

URDHËR

Nr. 628 datë, 21 . 8 .2024

**“PËR  
DEKLARIMIN E INTERESIT KULTUROR PËR OBJEKTIN “MURET ANTIKE TË  
ZBULUARA PRANË SHKOLLËS EFTALI KOÇI, DURRËS (KOD 1042)”**

Në vijim të shkresës nr.253/1 prot., datë 17.07.2024, paraqitur nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, Vendimit nr. 221, datë 05.07.2024, të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale,

**KONSTATOVA:**

Se është kompetencë e Ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, miratimi i deklarimit të pasurisë kulturore.

Nisur sa më sipër, në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 62 të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”,

**URDHËROJ:**

1. Deklarimin si pasuri kulturore të objektit “Muret antike të zbuluara pranë shkollës Eftali Koçi” dhe dhënien e statusit të mbrojtjes “Monument Kulture Kategorja e I-rë, me vendodhje Bashkia Durrës (Kodi i arkivit 1042).
2. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Drejtorja e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, për komunikimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**  
**Blendi GONXHJA**